

NJOFTIM
Nr. 3270, datë 16.4.2021

**PËR SHPALLJEN E DY VENDEVE VAKANTE PËR POZICIONIN E KËSHILLTARIT
LIGJOR**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar)).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 8 maj 2021, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, e cila konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.